



RREGULLAT SHTËPIAKE TË RENDIT SË ESPOONKRUUNU- SË (GODINAT)

Këto rregulla janë pranuar në mënyrë që të iu sigurohet banorëve knaqësi e banimit dhe qetësi shtëpiake. Të gjithë me sjelljet e tyre duhet të kenë konsideratë ndaj banorëve tjerë të ndërtesës. Banorët duhet poashtu të kujdesen për atë që edhe musafirët / vizitorët të iu përmbahen rregullave.

LAJMËRIMI PËR NDËRRIMIN E VENDBANIMIT

Sipas ligjit për çdo vendosje në banesë dhe zhvendosje prej saj duhet lajmëruar zyrën e vendit (maistraatti) e poashtu në mënyrë që Espoonkruunu të mund të përkujdeset për administratën e brendshme duhet lajmëruar edhe shërbimin për klient (asiakaspalvelu).

LOKALET E PËRBASHKËTA

Dyert e lokaleve të përbashkëta duhet mbajtur të mbyllura prej orës 21.00 deri në 07.00 dhe kur të kalohet nëpër to duhet kujdesuar që ato të mbyllen. Në lokalet e përbashkëta duhet lëvizur pa zhurmë dhe qëndrimi i panevojshëm e pirja e duhanit në to janë të ndaluara. Rrugët për qarkullim të lokaleve të përbashkëta dhe të vendeve të oborrit duhet mbajtur të pastërta dhe të jenë të lira. Për siguri ndaj zjarrit gjësendet mund të ruhen vetëm në vendet e rezervuara për ato. Vendosja e tabelave, reklamave, antenave etj. është e lejuar vetëm me lejen e firmës.

VENDET PËR LARJEN E RROBAVE

Këto vende mund të përdoren prej orës 9 deri në 21 sipas listës së rezervimeve. Vendi për larjen e rrobave pas përdorimit duhet të lihet në gjendje të pastër dhe të kujdesohet për atë që rryma të jetë e çyqur. Në lavatriqe nuk guxon të lahen tepihët. Prej dhomës për tharjen e rrobave duhet që secili të i mbledhë rrobat e veta menjëherë pasi që janë tharë/terur.

PËRKUJDESIMI NDAJ MBETURINAVE

Mbeturinat shtëpiake dhe mbeturinat tjera duhet hudhur të paketuara në kontainerët e mbeturinave duhet i konsideruar udhëzimet e dhëna për sortimin e mbaturinave. Për transportimin e mbeturinave tjera se sa atyre shtëpiake (në mes tjerash mobiljet duhet që banorët të kujdesen vetë. Mbeturinat problematike sikurse qelqi, bateritë, pajisjet elektronike etj. duhet dërguar në vendet e caktuara nga ana e YTV-SË.

VENDET PËR AUTOMJETE (AUTOPAİKAT)

Parkimi i automjeteve është i lejuar vetëm në vendet e rezervuara dhe të shënuara për këtë gjë. Mbajtja e automjetit ndezë në vend është e ndaluar. Nga lërja e automjeteve të vjetër dhe e pjesëve të automjeteve në vendet për automjete mund të pasojë obligim për pagesa të caktuar për pronarin e vendit për automjet.

BANESAT

Sjellje penguese e cila i pengon fqinjët është e ndaluar. Prej orës 22 deri në 07 duhet mundësuar qetësi të natës të gjithë fqinjëve. Për punët riparuese që bëhen me lejën e firmës dhe atyre punëve që shkaktojnë zhurmë dhe pengesë duhet lajmëruar më herët, dhe ato duhet që të kryhen gjatë ditëve të punës para orës 21. Për banesat duhet kujdesuar me kujdes. Për rrjedha të ujit, dëmeve tjera të gypave dhe konstruktive duhet menjëherë të lajmërohet personeli kujdesues.

Në WC dhe kanalizime tjera nuk bën të derdhen apo hudhen mbeturina të cilat mund të shkaktojnë nxënjen e tyre apo dëme.

BALLKONET

Shkundja e tepihëve dhe e rrobave të shtratit në ballkone është e ndaluar dhe në përgjithësi është e lejuar vetëm në vendet e rezervuara për këtë qëllim, pra e hënë deri e premte prej orës 8 deri 20, e shtunë prej 8-18, e diel dhe ditë feste e ndaluar. Ajrosja e rrobave të trupit dhe rrobave të shtratit si dhe tharja / terja e rrobave të vogla është e lejuar në ballkone vetëm nëpër vendet e dedikuara / rezervuara për këtë qëllim. Bërja e grillit në ballkone është absolutisht e ndaluar, sikurse edhe të ushqyerit e zogjve dhe kitrave.

KAFSHËT SHTËPIAKE

Jashtë banesave kafshët duhet mbajtur të lidhura dhe ato nuk guxojnë t'i pengojnë banorët e banesës. Shëtitja e kafshëve shtëpiake nëpër vendet e rezervuara për lojë të fëmijëve e poashtu edhe në afërsi të tyre është rrepsisht e ndaluar.

THYERJA E RREGULLAVE TË RENDIT

Thyerja e rregullave të rendit mund të shkaktojë obligimin për të kompenzuar ndonjë dëm apo përfundimin e të së drejtës për banim apo prishjen e kontratës së qirasë për banesë.